

Prishtinë, 14.01.2008
Kodi i ZRRE-së: D_78__2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Kërkesën e KEK SH.A-së të datës 21 maj 2007, për derogim në zbatimin e Neneve 16.4 dhe 22.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
3. Kërkesën e KEK Sh.A-së të datës 16.11.2007 për “Zgjatjen e afatit të procedurës për shkyçje –Vendimi-D_53_2007”.
4. Raportin e KEK Sh.A-së lidhur me rezultatet e “Zbatimit të vendimit D_53_2007” të datës 04.01.2008, **në seancën e mbajtur më 14 janar 2008 ka nxjerrë këtë:**

VENDIM

I. REFUZOHET kërkesa e KEK SH.A-së e datës 16.11.2007 mbi derogimin e Neneve 22.1 dhe 16.4 të Rregullit mbi Shkyçjet dhe Rikycjet e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

1. Me datë 16 nëntor 2007 KEK Sh.A ka kërkuar nga ZRRE-ja derogimin (shtyrjen e afatit për zbatim) e neneve 22.1 dhe 16.4 **mbi vazhdimin e shkyçjeve të konsumatorëve komercialë edhe jashtë orarit të punës, ditëve të pushimit dhe festave**, e që lidhen me përdorim të energjisë elektrike sipas Nenit 5 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë (RrShRKSEK).
2. ZRRE në vendimin D_53_2007 i ka lejuar KEK Sh.A-së derogim të neneve 22.1 dhe 16.4 për periudhën prej gjashtë (6) muajsh, dhe duke u bazuar në Nenin 5 të Rregullit mbi Shkyçjet dhe Rikycjet Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ka kërkuar nga KEK SH.A. që: “në afat jo më vonë se tre (3) muaj nga data e miratimit të këtij vendimi, t’i propozojë Bordit të ZRRE-së për shqyrtim dhe miratim Politikat për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve që Konsumojnë Energjinë Elektrike sipas këtij rregulli”. Gjithashtu ZRRE ka kërkuar nga KEK Sh.A raportin mbi shkyçjet dhe rikycjet e bëra nga KEK-u për periudhën gjashtë (6) mujore, sasinë e energjisë së rikuperuar brenda gjashtë muajve, vlerën e energjisë së rikuperuar, të arriturat e KEK-ut nga derogimi etj.

3. Deri me datë 10.01.2007 KEK-u nuk ka arritur të përgatisë Politikën për Shkryçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve sipas Nenit 5 të Rregullit mbi ShRKSEK.
4. Sipas vlerësimit të të dhënave nga raporti i KEK-ut të dërguara me datë 27.12.2007, ZRRE ka vlerësuar se efektet e arritura nga shkryçjet e konsumatorëve komercialë nuk e arsyetojnë vazhdimin e derogimit sipas vendimit D_53_2007.
5. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Pala e pakënaqur kundër këtij Vendimi mund të paraqesë ankesë në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
7. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Naim Bejtullahu, Anëtar

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar